

## URDHËR

Nr.149, datë 20.4.1999

### **PËR INFORMACIONET DHE TË DHËNAT QË DUHET TË DËRGOHEN NGA SUBJEKTET QË VEPROJNË NË FUSHËN E PËRPUNIMIT, TRANSPORTIMIT E TREGTIMIT TË NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”

#### URDHËROJ:

Të gjitha subjektet e përcaktuar në nenet 12, 13 e 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, janë të detyruar të dërgojnë në Ministrinë e Ekonomisë Publike e Privatizimit (Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve) informacionet e të dhënat si më poshtë:

#### I. Rafineritë

1. Brenda datës 15 tetor të çdo viti informacionet për:

- a) parashikimin për naftën bruto dhe gazin që do të përpunohet gjatë vitit pasardhës, i ndarë sipas burimit të sigurimit të tyre;
- b) parashikimin për nënproduktet që do të prodhohen gjatë vitit pasardhës të specifikuar sipas llojeve;
- c) parashikimin për nivelin e treguesve të projektit teknologjik që lidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- ç) parashikimin për ndryshime (në rast se ka) të projektit teknologjik ekzistues, rikonstruksione apo shtesa.

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti të dhënat për:

- a) sasitë e naftës bruto të përpunuara gjatë vitit paraardhës;

b) sasi të e nënprodukteve të prodhuara gjatë vitit paraardhës e sasi të e shitura, të ndara sipas llojit të nënproduktit dhe subjektit që ka realizuar blerjen;

c) treguesit faktik të konstatuar gjatë vitit paraardhës që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

3. Të dhënat për sasi të e naftës bruto e të gazit të siguruara e të përpunuara gjatë periudhës tremujore, si dhe sasi të e nënprodukteve të prodhuara e të shitura, brenda 20 ditëve nga data e mbylljes së tremujorit.

Të dhënat që i përkasin tremujorit IV dërgohen në afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Informacion për ndërprerjen e procesit të prodhimit, shkaqet që kanë çuar në të, si dhe masat për rifillimin e punës, kur ndërprerja është për një periudhë më të gjatë se 7(shtatë) ditë dhe nuk ka të bëjë me riparime apo ndërhyrje të tjera teknike të parashikaura.

## II. Naftësjellësit e gazsjellësit

1. Brenda datës 15 tetor të çdo viti informacionet për:

a) parashikimin për naftën bruto dhe gazin që do të transportohet për vitin pasardhës, i ndarë sipas burimit të sigurimit të tyre;

b) parashikimin për sasi të e naftës bruto e të gazit që do të konsumohen gjatë viti pasardhës, të ndarë sipas konsumatorëve;

c) parashikimin për degëzime të reja të naftësjellësit apo gazsjellësit, si dhe konsumatorët e mundshëm të tyre;

ç) parashikimin për ndryshime të projektit ekzistues, rikonstruksione apo shtesa.

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti të dhënat për:

a) sasi të e naftës bruto apo gazit të transportuara gjatë vitit paraardhës;

b) sasi të e naftës bruto e të gazit të konsumuara gjatë vitit paraardhës, të ndarë sipas konsumatorëve.

3. Të dhënat për sasi të e naftës bruto e të gazit të transportuara gjatë periudhës tremujore, si dhe ato të dërguara te konsumatorët brenda 20 ditëve nga data e mbylljes së tremujorit. Të dhënat që i përkasin tremujorit të katërt dërgohen në afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Informacion për ndërprerjen e procesit të transportimit, shkaqet që kanë çuar në të, si dhe masat për rifillimin e punës e që nuk kanë të bëjnë me riparime apo ndërhyrje të tjera të planifikuara.

5. Kopje të kontratave të blerjes.

### III. Shoqëritë e tregtimit me shumicë

1. Brenda datës 15 tetor të çdo viti informacione për:

a) parashikimin për naftën bruto, gazin dhe nënproduktet e tyre që do të importohen apo do të sigurohen nga rafineritë brenda vendit gjatë vitit pasardhës, ndarë sipas burimit të sigurimit të tyre;

b) Parashikimin për sasi të naftës bruto, të gazit e nënprodukteve të tyre që do të tregtohen gjatë vitit pasardhës, të specifikuara sipas llojeve.

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti të dhënat për:

sasi të naftës bruto, gazit e nënprodukteve të tyre të siguruara, të importuara e të tregtuara gjatë vitit paraardhës, të ndarë sipas llojeve, burimeve të sigurimit dhe kontraktuesve kryesorë.

3. Të dhënat për sasi të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre të siguruara, importuara e të tregtuara gjatë periudhës tremujore, të ndara sipas llojeve, brenda 20 ditëve nga data e mbylljes së tremujorit. Të dhënat që i përkasin tremujorit të katërt dërgohen brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Informacion për ndërprerjen e veprimtarisë, shkaqet që kanë çuar në të dhe masat për rifillimin e punës, kur ndërprerja është për një periudhë më të gjatë se 7 (shtatë) ditë dhe nuk ka të bëjë me rregullime apo çështje të tjera të parashikuara.

III. Të gjitha subjektet e mësipërme janë të detyruara të dërgojnë pranë Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit informacion të menjëhershëm për aksidentet që ndodhin në objektet, instalimet apo pajisjet e tyre, shkaqet e këtyre aksidenteve, pasojat dhe masat e marra për eliminimin e tyre.

IV. Të gjitha informacionet dhe të dhënat e kërkuara sipas pikave të mësipërme duhet të dërgohen me shkrim dhe të firmosura rregullisht nga drejtuesi i subjektit.

V. Subjektet e mësipërme, përveç informacioneve e të dhënave të përcaktuara në këtë urdhër, janë të detyruara të dërgojnë në organet shtetërore të dhënat që kërkohen nga dispozitat ligjore për statistikën.

VI. Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve të botojë sipas një formulari të miratuar treguesit e realizuar. Gjithë të dhënat e tjera janë konfidenciale dhe nuk mund t'u jepen personave të tjerë për përdorim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

Ylli Bufi